



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE



VENDIM

Nr. 48, datë 30.1.2019

Handwritten signature and text: "Kuvendi i Republikës"

PËR

**PROPOZIMIN KUVENDIT PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI
TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 114, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Propozimin Kuvendit për emërimin e znj. Xhoana Lilaj anëtar të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

Handwritten signature of Belinda Balluku

RELACION

PËR

VENDIMIN “PËR PROPOZIMIN KUVENDIT PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT DREJTUES TË AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky vendim ka për qëllim propozimin Kuvendit të Shqipërisë për emërimin e znj. Xhoana Lilaj si anëtare të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për plotësimin e vendit të mbetur vakant pas mbarimit të mandatit 4-vjeçar të znj. Klarina Allushi (Abazaj).

Sa më sipër, për përfundimin e mandatit të znj. Allushi, Këshilli i Ministrave është njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë me shkresën nr.3966 prot., datë 19.12.2018.

Ky vendim bazohet në nenin 114, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky vendim nuk është planifikuar në projektaktet e vitit 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Këshilli Drejtues i AKEP-it përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.

Në kushtet e përfundimit të mandatit të një prej anëtarëve të këtij Këshilli, në mbështetje të pikës 3, të nenit 114, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, është e nevojshme që Këshilli i Ministrave t’i propozojë Kuvendit kandidatin për emërimin e anëtarit zëvendësues të Këshillit Drejtues të AKEP-it.

Sipas pikës 3, të nenit 114, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Drejtues përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët zgjidhen nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje jo më shumë se 1 herë.

Si dhe në bazë të pikës 4, të nenit 114, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të jenë specialistë, me arsim të lartë, të kualifikuar, që kanë, të paktën, 10 vjet përvojë pune dhe të jenë përfaqësues nga sektori i komunikimeve elektronike, postar, i ekonomisë dhe i drejtësisë.

Me anë të këtij vendimi synohet që Këshilli i Ministrave t’i propozojë Kuvendit emërimin e znj. Xhoana Lilaj si anëtare të AKEP-it. Në bazë të jetëshkrimit, znj. Lilaj plotëson kriteret e kërkuara dhe ka eksperiencën e nevojshme të kërkuar nga pikat 3 dhe 4, të nenit 114, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Vendimi i propozuar është në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës dhe nenin 114, të ligjit nr.9918, datë 19.5.2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky vendim nuk përfron ndonjë *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky vendim i propozon Kuvendit emërimin e znj. Xhoana Lilaj si anëtare të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e vendimit ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, i cili ia përcjell për procedim Kuvendit të Shqipërisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky vendim është hartuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Vendimi i paraqitur nuk ka efekte financiare për buxhetin e shtetit.


KËSHILLI I MINISTRAVE

NR.PROT.626/1
DATË 4 2 .2019

KUVENDIT
AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI



The image shows a handwritten signature in black ink, which appears to be 'Engjëll Agaçi'. To the right of the signature is a circular official stamp. The stamp contains the text 'MINISTRI I KOMUNIKIMEVE DHE POSTARE' around the top inner edge and 'MINISTRATË' around the bottom inner edge. In the center of the stamp is a small emblem, likely the coat of arms of Albania.